

=====

E drejta për t'u informuar për natyrën dhe shkakun e akuzës

Enkeleda Xhengo (OSMANI)

Ph.D. Candidate, Prosecutor,
enkeledao@yahoo.com

Abstrakt

Kur një person është i akuzuar për një vepër penale, lind një detyrim i mëtejshëm për autoritetet përkatëse që të marrin hapa aktivë për të siguruar atë person me informacion të detajuar rreth akuzës kundër tij dhe për të siguruar se e kupton atë. E drejta e të akuzuarit për t'u informuar për natyrën dhe motivet e akuzës duhet të konsiderohet në këndvështrimin e të drejtës së tij për të përgatitur mbrojtjen. Kështu, nëse gjyqtarët e themelit disponojnë, kur kjo e drejtë i është njohur në të drejtën e brendshme, mundësinë për të rikualifikuar faktet, ata duhet të sigurohen që të pandehurit kanë pasur oportunitetin të ushtrojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes në mënyrë korrekte dhe efektive. Qëllimi i këtij punimi është të japë një vështrim të përgjithshëm mbi të drejtën për t'u informuar për natyrën dhe shkakun e akuzës, ndalur në parashikimet ligjore, si edhe praktikën gjyqësore.

Fjalë kyçe: informim, proces, akuzë, praktikë

Hyrje

Të gjithë personat që janë arrestuar kanë një të drejtë themelore për të kuptuar se pse ata janë duke u privuar nga liria. Neni 5 (2) i KEDNJ-së thotë se "*secili person i arrestuar duhet të informohet menjëherë, në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe akuzës kundër tij*". Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ("GJEDNJ"), ka shpjeguar se kjo është një mbrojtje thelbësore kundër trajtimit arbitrar dhe pjesë përbërëse e skemës së mbrojtjes së ofruar nga neni 5²³. Fjala "Arrestimi" ka një kuptim autonom dhe i referohet momentit në të cilin një person është privuar nga liria e tij.²⁴ Të gjithë të burgosurit duhet të sigurohen me këtë informacion në mënyrë që ata të mund të sfidojnë ligjshmërinë e paraburgimit të tyre. Sipas KEDNJ-së, "*çdokush, i autorizuar të ndërmarrë procedura duhet të ketë*

²³ *Shamayev and Others v. Georgia and Russia, ECtHR, Judgment of 12 April 2005 para. 413*

²⁴ *Van der Leer v. the Netherlands, ECtHR, Judgment of 21 February 1990, para 27*

=====

ligjshmërinë e paraburgimit nuk mund të bëjë përdorimin efektiv të kësaj të drejte, përveç nëse ai ose ajo është menjëherë dhe në mënyrë adekuate i informuar për arsyet ku wshtw mbështetur privimi nga liria e tij".

Informacioni duhet të jetë i shprehur në mënyrë që personi tw mund ta kuptojë, duke përdorur "gjuhë të thjeshtë, jo teknike", dhe ajo duhet të mbulojë "bazat ligjore dhe faktike" për arrestimin²⁵. në Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar KEDNJ-ja deklaroi se ishte e pamjaftueshme për një oficer arrestimi thjesht për t'u treguar të dyshuarëve që ata u arrestuan në bazë të një ligji të veçantë me dyshimin se qenë terroristë. Në vend të kësaj, ata duhet të ishin informuar për *"arsyet pse ata ishin të dyshuar për të qenë terroristë"* dhe të *"përfshirjes së tyre të dyshuar në akte të veçanta penale dhe anëtarësimit të tyre të dyshuar në organizatë të paligjshme"*.

Informimi mbi akuzën

KEDNJ

Neni 6 (3) (a) i KEDNJ-së parashikon se: *"çdokush që akuzohet për një vepër penale duhet të informohet menjëherë, në një gjuhë që ai e kupton dhe në detaje, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij"*. GJEDNJ ka shpjeguar arsyen e këtij neni: të dyshuarit duhet t'i sigurohet informacion i mjaftueshëm sa është i nevojshëm "për të kuptuar plotësisht shkallën e akuzave kundër tij, me synim përgatitjen e një mbrojtje adekuate".²⁶ Nëse dhënia e informacionit është e mjaftueshme duhet të vlerësohet në dritën e Nenit 6 (3) (b) të KEDNJ-së, i cili i jep të gjithë të drejtën që të ketë kohën dhe lehtësitë për përgatitjen e mbrojtjes adekuate, dhe në dritën e një të drejtë të përgjithshme për një proces të drejtë që parashikohet në Nenin 6 (1) të KEDNJ.²⁷

Njoftimi për natyrën dhe shkakun e akuzës është një detyrë pozitive që kërkon hapa aktivë nga prokurori ose policia. Nuk është e mjaftueshme për të vënë informacion në dispozicion vetëm në qoftë se i dyshuari e kërkon atë. GJEDNJ-ja ka theksuar se detyra *"qëndron tërësisht mbi supet e autoritetit ndjekës dhe nuk mund të përmbushet me pasivitet duke vënë informacion në dispozicion, pa e çuar atë në vëmendjen e mbrojtjes"*. Për autoritetet mund të jetë e nevojshme të ndërmarrin hapa shtesë për të sjellë informacionin në vëmendjen e të dyshuarit dhe për të siguruar se i dyshuari efektivisht e ka kuptuar informacionin. Fakti se një i dyshuar ka të drejtë për të hyrë në regjistrin e dëshmimeve nuk i liron autoritetet apo prokurorinë nga detyrimi për të informuar të dyshuarin menjëherë dhe në mënyrë të detajuar

²⁵ Fox, Campbell and Hartley v the UK, ECtHR, Judgment of 30 August 1990, para. 40

²⁶ Mattoccia v Italy, ECtHR, Judgment of 25 July 2000, para. 60.

²⁷ Vaudelle v France, ECtHR, Judgment of 30 January 2001, para. 35; F.C.B. v Italy, ECtHR, Judgment of August 1991, para. 29.

=====

për akuzën e plotë kundër tij.

Në lidhje me formën e informacionit, neni 6 (3) (a) i KEDNJ nuk imponon asnjë kërkesë specifike sa i përket mënyrës në të cilën i dyshuari duhet të informohet për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij. Në disa rrethana, njoftimi me gojë mund të jetë i pranueshëm, por në të tjera rrethana, GJEDNJ-ja ka pohuar se kërkohet njoftimi me shkrim, duke vënë në dukje për shembull, se një i pandehur i huaj mund të vihet në një disavantazh në qoftë se ai nuk është i pajisur me një përkthim me shkrim të aktakuzës në një gjuhë që ai kupton.²⁸

Lidhur me thelbin e informacionit, i dyshuari duhet të njoftohet për "*faktet materiale të supozuara kundër tij që janë në bazë të akuzës, dhe nga natyra e akuzës, përkatësisht, me cilësimin juridik të këtyre fakteve materiale*". Shuma, detajet dhe saktësia e informacionit që duhet t'i komunikohet të dyshuarit, si dhe momenti se kur informacioni duhet të komunikohet, varet nga kompleksiteti i veçantë dhe natyra e çështjes.²⁹ Neni 6 (3) (a) kërkon që informacioni të jepet menjëherë, gjatë fazave paraprake të procedurave. Në *Mattoccia v Itali*, GJEDNJ-ja ka kritikuar autoritetet kombëtare për të mos siguruar informata të mjaftueshme për të dyshuarin para intervistës së tij të parë me policinë, dhe jo duke lejuar qasje në provat në dosjen e akuzës deri në fund të hetimit paraprak. Prandaj, është gjithashtu e papranueshme për prokurorinë të ndryshojë akuzën pa njoftuar të akuzuarin. Kështu, në *Pélissier dhe Sassi kundër Francës*, GJEDNJ gjeti shkelje të Nenit 6 (3) (a) me arsyetimin se aplikantët nuk janë njoftuar se faktet ndaj tyre ishin riformuluar dhe se ata ishin të dyshuar për një variant të krimit origjinal.³⁰

Në çështjet penale, ku jeta dhe liria e të akuzuarit është në rrezik, kërkohet që i akuzuari të informohet për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij. Një i akuzuar nuk mund të dënohet për një vepër penale, nëse nuk është akuzuar qartë në ankesë apo informacion. Për të dënuar atë mbi një kundërvajtje tjetër nga ajo, akuzuar në padi apo informacion do të ishte një shkelje e kësaj të drejte kushtetuese. E rëndësishme është që të realizohet përshtetimi i aktit me siguri të mjaftueshme në mënyrë që i akuzuari të mund të vlerësojë natyrën e akuzës kundër tij dhe për të shmangur ndonjë surprizë të mundshme që mund të çojë në padrejtësi. Përndryshe, i akuzuari do të mbetet në gjendjen e palakmueshme duke spekuluar se pse është bërë objekt i një ndjekje penale.

Direktiva e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për të drejtën e informimit në procedurat penale

Në Bashkimin Evropian, mbrojtja e të drejtave të personave të dyshuar dhe të akuzuar në një proces penal është bazuar në Konventën Evropiane për të Drejtat

²⁸ *Kamasinski v Austria, ECtHR, Judgment of 19 December 1989, para. 79.*

²⁹ *Pélissier and Sassi v France, ECtHR, Judgment of 26 March 1999, para. 51.*

³⁰ *Pélissier and Sassi v France, ECtHR, Judgment of 26 March 1999, para. 50-56.*

=====

e Njeriut. E drejta për informim tani është ligjëruar në BE, me ndikime të rëndësishme mbi detyrimet e Shteteve Anëtare. Më 26 prill 2012, Këshilli i Bashkimit Evropian dhe Parlamenti miratoi një urdhëresë për të mbrojtur të drejtën e njerëzve për informim në procedurën penale³¹, si pjesë e Rezolutës në një Udhërrëfyes për forcimin e të drejtave procedurale të personave të dyshuar dhe personave të akuzuar në Procedurën Penale ("Udhërrëfyesi i BE-së").

Kjo Direktivë përcakton kërkesat minimale të gjithë BE-së për njoftimin e të dyshuarve dhe personave të akuzuar në lidhje me çështjen e ngritur kundër tyre. Të gjitha shteteve anëtare u kërkohet të sjellin në fuqi ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme për të siguruar që ato të jenë në përputhje me Direktivën. Direktiva është e detyrueshme dhe e zbatueshme; individët mund të kryejnë veprime kundër shtetit për çdo dështim të tij për t'a zbatuar si duhet atë³².

Neni 3 i Direktivës kërkon që çdo person i cili është i dyshuar ose i akuzuar për një vepër penale - pavarësisht nëse ato kanë qenë të arrestuar, ndaluar, apo akuzuar zyrtarisht - duhet të pajisen me informata themelore për të drejtat e tyre procedurale. Ky nen parashikon se: *"Shtetet Anëtare do të sigurojnë që të dyshuarit apo personat e akuzuar do të pajisen menjëherë me informacion në lidhje me të paktën të drejtat procedurale, në vijim, siç ato zbatohen sipas ligjit kombëtar, në mënyrë që të lejojnë për ato të drejta që të ushtrohen në mënyrë efektive:*

- (a) të drejtën e mbrojtjes me avokat;*
- (b) e drejta për këshillim ligjor falas dhe kushtet për marrjen e këshillave të tilla;*
- (c) të drejtën për t'u informuar për akuzën, në përputhje me nenin 6;*
- (d) të drejtën për interpretim dhe përkthim;*
- (e) të drejtën për të heshtur.*

Sipas Direktivës, Shtetet Anëtare do të sigurojnë që informacioni i dhënë në paragrafin 1 do të jepet me gojë ose me shkrim, në gjuhën e thjeshtë dhe të kuptueshme, duke marrë parasysh çdo nevojë të veçantë të personave vulnerabël të dyshuar apo akuzuar.

Neni 6 i Direktivës posaçërisht mbron të drejtën për t'u informuar në lidhje me akuzën. Të gjithë të dyshuarit dhe personat e akuzuar duhet të jenë *"të pajisur me informacion në lidhje me veprën penale që ata janë të dyshuar apo akuzuar se e kanë kryer. Ky informacion duhet të sigurohet menjëherë dhe në detaje të tilla siç është e nevojshme për të mbrojtur drejtësinë e procedurave dhe ushtrimin efektiv të të drejtave të mbrojtjes"*.

Direktiva mbi të Drejtën e Informimit përmban detyrime të hollësishme për

³¹ Directive of the European Parliament and of the Council on the Right to Information in Criminal Proceedings, 2010/0215(COD), COM(2010) 392/3. Mund të gjendet online: www.eujusticia.net

³² Van Duyn v Home Office, ECJ, Judgment of 4 December 1974

=====

të gjitha shtetet anëtare të BE-së, dhe përcakton rregullat minimale për dhënien e informacionit të të dyshuarve dhe personave të akuzuar. Këto detyrime, të cilat reflektojnë dhe sqarojnë standardet minimale të përcaktuara nga KEDNJ, duhet të zbatohen në ligjin kombëtar dhe praktikën e të gjitha shteteve anëtare.

Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike

Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut ka pohuar parimet e përcaktuara nga GJEDNJ që të gjithë njerëzit kanë të drejtë të informohen për arsyet e arrestimit dhe për t'u pajisur me detaje në lidhje me natyrën dhe shkakun e akuzave kundër tyre. Komiteti për të Drejtat e Njeriut ka shkuar edhe më tej se KEDNJ-në dhe përcakton atë që ata e konsiderojnë të jetë njoftim "të shpejtë".

Neni 9 (2) të KNDKP parashikon se *"ai që është i arrestuar duhet të informohet, në momentin e arrestimit, për arsyet e arrestimit të tij dhe do të informohet menjëherë për çdo akuzë kundër tij"*. Komiteti ka shpjeguar se *"një nga arsyet më të rëndësishme për kërkesën e informacionit" të shpejtë "për një vepër penale është për t'i mundësuar një individ të ndaluar për të kërkuar një vendim të shpejtë mbi ligjshmërinë e ndalimit të tij apo të saj nga një autoritet gjyqësor kompetent"*³³. Në *Krasnova kundër Kirgistan*, Komiteti i të Drejtave të Njeriut ka sqaruar atë që konsiderohet të jetë njoftimi 'i shpejtë', duke gjetur shkelje të nenit 9 (2) për shkak se ankuesi nuk kishte qenë i informuar për arsyet e arrestimit të tij për 24 orët e para që ai ishte ndaluar.³⁴

Neni 14 (3) (a) i KNDKP pasqyron Nenin 6 (3) (a) i KEDNJ-së duke konfirmuar se çdokush që akuzohet për krim duhet *"të informohet menjëherë dhe në detaje në një gjuhë që ai e kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij"*. Megjithatë, Komiteti i të Drejtave të Njeriut ka shkuar më tej se KEDNJ ka specifikuar se si kjo e drejtë duhet të respektohet në praktikë. Në Komentin e Përgjithshëm, Komiteti i të Drejtave të Njeriut ka dhënë në vijim udhëzim të plotë dhe gjithëpërfshirës në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 14 (3) (a) të KNDKP.

Së pari, në lidhje me objektin e së drejtës, Komiteti njeh shprehimisht që të gjithë njerëzit të cilët janë të akuzuar për një vepër penale kanë të drejtë të jetë të informuar për akuzat kundër tyre, pavarësisht nëse ata janë arrestuar formalisht apo ndaluar. Komiteti ka specifikuar se neni 14 (3) (a) *"vlen për të gjitha rastet e akuzave penale, duke përfshirë edhe ato të personave jo në paraburgim, por jo të hetimeve penale paraprirë shtrimin e akuzave"*.³⁵

Së dyti, në lidhje me kohën e njoftimit Komisioni deklaroi se " e drejta për t'u

³³ *Campbell v Jamaica, UNHRC, Decision of 30 March 1992, U.N. Doc CCPR/C/44/D/248/1987*

³⁴ *Krasnova v Kyrgyzstan, UNHRC, Decision of 29 March 2011*

³⁵ *UNHRC, General Comment No. 32, Right to equality before the courts and tribunals and to a fair trial, UN Doc. CCPR/C/GC/32, 23 August 2007, para. 32, 34.*

informuar për akuzën, “menjëherë”, kërkon që informacioni të jepet sa më shpejt që personi në fjalë është akuzuar zyrtarisht me një vepër penale sipas ligjit të brendshëm, ose individi është emëruar publikisht si i tillë”.³⁶ Në *Éilliams v. Xhamajka*³⁷, Komiteti më tej sqaroi se informacione të detajuara në lidhje me akuzat duhet të ofrohen në fillim të hetimeve paraprake ose në ndonjë seancë tjetër që krijon një dyshim të qartë zyrtar kundër të akuzuarit .

Së treti, në lidhje me formën e njoftimit, Komiteti sqaroi që informimi i të dyshuarit për akuzat ndaj tij me gojë është i pranueshëm vetëm nëse njoftimi është konfirmuar më vonë me shkrim³⁸. Kjo rafinon hendekun në standardet e vendosura nga GJEDNJ-ja dhe mbështet rëndësinë e sigurimit të të dyshuarit se e kupton informacionin e dhënë.

E drejta për t’u njohur me akuzën nën praktikën e Gjykatës Kushtetuese të RSH

Në jurisprudencën e GJK është pranuar se gjykimi kushtetues synon të vlerësojë nëse procesi si i tërë ka qenë i rregullt, duke u ndaluar në ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të palëve në proces. Në vendimet e veta GJK nuk ka pranuar cenimin e parimit për një proces të rregullt ligjor në rastet kur gjykata e shkallës më të lartë, duke u bazuar në kompetencat që i jep Kodi i Procedurës Penale, ka plotësuar apo ka korrigjuar mangësitë dhe gabimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementëve të një procesi të rregullt ligjor.³⁹ Në këtë linjë, GJK e ka lidhur në mjaft raste të drejtën për t’u njohur me aktet e dosjes (akuzën/padinë, provat etj) me realizimin efektiv të së drejtës së mbrojtjes. Ajo ka theksuar se “*e drejta e mbrojtjes nuk mund të realizohet nëse palëve në proces nuk u jepet mundësia të njihen me aktet e dosjes dhe pretendimet e palës kundërshtare*”.⁴⁰ Po këtë qëndrim ka mbajtur GJK edhe në rastet kur nga kërkuesi është pretenduar mosmarrja njoftim për rekursin e bërë nga pala tjetër. Ajo ka theksuar se “*e drejta për të qenë i pranishëm në gjykim është pjesë përbërëse e së drejtës për t’u mbrojtur. Kjo e drejtë i ngarkon autoritetet me detyrat që të njoftojnë në kohë të mjaftueshme palët dhe mbrojtësit e tyre për datën dhe vendin e mbajtjes së procedurave gjyqësore, për të kërkuar praninë e tyre dhe për të mos i përjashtuar ato padrejtësisht nga gjykimi*”.⁴¹

Në vazhdimësi ajo nuk ka hezituar të ritheksojë respektimin e të drejtës për

³⁶ UNHRC, General Comment No. 32, Right to equality before the courts and tribunals and to a fair trial, UN Doc. CCPR/C/GC/32, 23 August 2007, para. 32, 34.

³⁷ Desmond Williams v. Jamaica, UNHRC, Decision of 8 April 1997

³⁸ UNHRC, General Comment No. 32, Right to equality before the courts and tribunals and to a fair trial, UN Doc. CCPR/C/GC/32, 23 August 2007, para. 31.

³⁹ Vendim i GJK nr.21/2008

⁴⁰ Vendim i GJK nr.7/2005

⁴¹ Vendim i GJK nr.11/2005

=====

t'u njoftuar për gjykimin por edhe për të marrë dijeni për aktet e paraqitura në gjykim me qëllim garantimin e procesit të rregullt ligjor. Ajo ka konstatuar shkelje kur palët nuk janë njoftuar sipas rregullave procedurale për seancat e gjykimit. *Lidhur me këtë, Gjykata Kushtetuese ka pranuar në vendimet e veta, se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, prandaj Gjykata e Lartë duhet të mbante një qëndrim të shprehur për të...Për sa më sipër, Gjykata çmon se në këtë aspekt ka patur cenim të parimit kushtetues të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor*".⁴²

GJK i ka konsideruar të mjaftueshme veprimet e gjykatës për njoftimin e rekursit avokatit të kërkuesit, kur ai ka qenë avokat i zgjedhur prej tij dhe e ka përfaqësuar kërkuesin në gjykimin në apel si dhe kur është konfirmuar marrja e rekursit nëpërmjet nënshkrimit të tij (avokatit).⁴³ GJK është ndalur gjatë tek standarti i procesit të rregullt kur bëhet fjalë për njoftimin e të pandehurit lidhur me akuzën ose procesin e filluar ndaj tij. Kështu ajo ka theksuar se *"është detyrë e autoriteteve shtetërore përkatëse që të njoftojnë në mënyrë rigoroze, konform kërkesave procedurale, të pandehurin ndaj të cilit ka filluar një proces penal, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet në përfundimin se i pandehuri ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim..."*.⁴⁴

Konkluzione dhe rekomandime

Të pandehurit duhet të informohen në kohë të përshtatshme, jo vetëm për motivet e akuzës, pra me faktet materiale që i atribuohen dhe mbi të cilat bazohet akuza, por edhe, dhe në mënyrë të detajuar, me kualifikimin juridik të dhënë këtyre fakteve.

Për respektimin e këtyre parimeve gjykatat duhet të përmbushin me rigorozitet një sërë detyrimesh. Synimi kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykatat, me objektivitet e paanësi.

Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij. Është detyrë e shtetit që të marrë masat e duhura për të garantuar pjesëmarrjen në procesin penal të personit të akuzuar ose mbrojtësit ligjor, qoftë edhe atij të caktuar kryesisht.

KEDNJ nuk imponon asnjë kërkesë specifike sa i përket mënyrës në të cilën i dyshuari duhet të informohet për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij. Në disa rrethana, njoftimi me gojë mund të jetë i pranueshëm, por në të tjera rrethana,

⁴² Vendim i GJK nr.27/2009

⁴³ Vendim i GJK nr.1/2008

⁴⁴ Vendim i GJK nr.30/2010

=====

GJEDNJ-ja ka pohuar se kërkohet njoftimi me shkrim, duke vënë në dukje për shembull, se një i pandehur i huaj mund të vihet në një disavantazh në qoftë se ai nuk është i pajisur me një përkthim me shkrim të aktakuzës në një gjuhë që ai kupton.

Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut ka pohuar parimet e përcaktuara nga GJEDNJ që të gjithë njerëzit kanë të drejtë të informohen për arsyet e arrestimit dhe për t'u pajisur me detaje në lidhje me natyrën dhe shkakun e akuzave kundër tyre. Komiteti për të Drejtat e Njeriut ka shkuar edhe më tej se KEDNJ-në dhe përcakton atë që ata e konsiderojnë të jetë njoftim "të shpejtë".

Bibliografia

- Campbell v Jamaica, UNHRC, Decision of 30 March 1992, U.N. Doc CCPR/C/44/D/248/1987
- Desmond Williams v. Jamaica, UNHRC, Vendim i 8 Prill 1997
- Kamasinski v Austria, ECtHR, 19 Dhjetor 1989
- Krasnova v Kyrgyzstan, UNHRC, 29 Mars 2011
- Fox, Campbell and Hartley v the UK, ECtHR, 30 Gusht 1990
- Mattoccia v Italy, ECtHR, 25 Korrik 2000
-
- Pélisser and Sassi v France, ECtHR, 26 March 1999
- Shamayev and Others v. Georgia and Russia, ECtHR, 12 Prill 2005
- UNHRC, General Comment No. 32, Right to equality before the courts and tribunals and to a fair trial, UN Doc. CCPR/C/GC/32, 23 Gusht 2007
- Van der Leer v. the Netherlands, ECtHR, 21 Shkurt 1990
- Vaudelle v France, ECtHR, 30 Janar 2001
- Vendim i GJK nr.7/2005
- Vendim i GJK nr.11/2005
- Vendim i GJK nr.27/2009
- Vendim i GJK nr.1/2008
- Vendim i GJK nr.30/2010.
-